



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, këtë javë dëshmuan tre dëshmitarë, dy dëshmitarë në seancë publike dhe një dëshmitar me masa mbrojtëse.

Dëshmitari i 107-ë filloi dhënien e dëshmisë të hënën. Sipas përmbledhjes që Prokuroria lexoi në sallën e gjyqit, Halil Qadraku iu bashkua UÇK-së rreth marsit 1998 dhe pati role të ndryshme në disa vende, ndër të cilat edhe në zonën operative të Pashtrikut. Dëshmia e z. Qadraku vazhdoi të martën, të mërkurën dhe të enjten në mëngjes.

Në vijim Prokuroria thirri dëshmitarin e 108-ë, që dëshmoi me masa mbrojtëse, ndjekur nga dëshmitari i 109-ë. Dëshmitari i 109-ë është Sokol Bashota dhe dëshmia e tij pritet të zgjasë për disa ditë.

Seanca e radhës në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* do të mbahet të hënën, më 2 dhjetor, duke filluar nga ora 9:00 e mëngjesit.

Më 26 nëntor, në çështjen *Januzi dhe të tjerët*, Trupi Gjykses I vendosi vazhdimin e paraburgimit të Ismet Bahtijarit, sepse konstatoi që ende ekzistojnë rreziqe që ai të pengojë ecurinë e procesit ose të kryejë vepra të tjera penale, dhe se këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të DHSK-së. Sipas kornizës ligjore të DHSK-së, gjykatësit duhet të marrin në shqyrtim nëse paraburgimi është ende i përligjur çdo dy muaj.

Në çështjen e Pjetër Shalës, Trupi Gjykses shqiptoi Urdhrin për Zhdëmtim sot në mëngjes, në seancë publike. Ky ishte urdhri i dytë për zhdëmtim i lëshuar në një çështje gjyqësore për krime lufte të gjykuar në Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Pjetër Shala u shpall fajtor më 16 korrik 2024 për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe u dënua më 18 vjet burgim, ku llogaritet koha e kaluar në paraburgim. Në këtë çështje gjyqësore, tetë viktimat pjesëmarrëse kërkuan zhdëmtim.

Trupi Gjykses urdhëroi z. Shala të paguajë një shumë prej 208.000 eurosh si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor. Kompensimet individuale për tetë viktimat janë midis 100.000 euro dhe 8.000 euro, dhe shtatë viktimave iu akordua bashkërisht gjithashtu edhe një shumë prej 50.000 eurosh. Këto shuma burojnë nga kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave, që Trupi Gjykses i gjykoi të arsyeshme dhe që pasqyrojnë shkallën dhe përmasat e dëmit që pësuan viktimat.





Trupi Gjykses theksoi se juridiksioni i tij në këtë çështje gjyqësore do të përfundojë me nxjerrjen e këtij Urdhri për Zhdëmtim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ftoi Kryetaren e DHSK-së të caktojë një Gjykatës të Vetëm për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim.

Megjithëse Trupi Gjykses rikujtoi se përgjegjësinë për pagesën e kompensimit për viktimat e mban ekskluzivisht z. Shala, ai theksoi se në kohën e lëshimit të Urdhrit për Zhdëmtim, z. Shala nuk duket se zotëron mjetet financiare për përmbushjen e plotë të urdhrin. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses diskutoi edhe aktorë të tjerë që mund të përfshihen për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim, sidomos Kosova.

Trupi Gjykses theksoi fillimisht se programi i Kosovës për kompensimin e viktimave të krimit mund të jetë një mënyrë për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim, edhe pse shumat maksimale që mund të akordohen nga ky program janë më të ulëta se ato të përcaktuara në Urdhrin për Zhdëmtim.

Trupi Gjykses theksoi gjithashtu se Kosova ende nuk ka ndërmarrë hapa konkretë për të garantuar realizimin e kompensimit për viktimat e krimeve që përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ftoi përsëri Kosovën që të miratojë ligjet e nevojshme dhe të krijojë një mekanizëm zhdëmtues për kompensimin e viktimave të krimeve që përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara.

Trupi Gjykses shpjegoi se ky hap (i) do të sigurojë detyrimin e Kosovës lidhur me të drejtat e viktimave sipas traktateve ndërkombëtare; (ii) do të arrijë trajtimin e barabartë midis viktimave, nga njëra anë, dhe të dyshuarve dhe akuzuarve para Dhomave të Specializuara, nga ana tjetër, të cilët mbështeten financiarisht për mbrojtjen e tyre nëpërmjet buxhetit të Kosovës; dhe (iii) do të shmangte diskriminimin midis viktimave të konfliktit të armatosur në Kosovë në 1998-1999..

Krahas kësaj, Trupi Gjykses vuri në dukje se tani ekziston mundësia që donatorët [të kontribuojnë me fonde të pakushtëzuara për Dhomat e Specializuara, nëse dëshirojnë të mbështesin](#) pagimin e kompensimit që u është akorduar viktimave në bazë të një urdhri për zhdëmtim të lëshuar nga Dhomat e Specializuara.

Trupi Gjykses theksoi se nisma e lartpërmendur nuk liron as z. Shala nga detyrimi për të kompensuar viktimat në përputhje me Urdhrin për Zhdëmtim, as Kosovën për të përmbushur detyrimet e saj ndaj viktimave brenda një kohe të arsyeshme, përmes krijimit të një mekanizmi zhdëmtues të mirëfilltë.

